



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:070143  
Datë: 21.02.2019  
Numri i dokumentit: 00230136

**DKR. P. nr.111/2018**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE – Departamenti për Krime të Rënda në Pejë**, Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Sylë Lokaj, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Binake Mulliqi, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Pejë, PP/I. nr.125/2018, dt.19.12.2018, kundër të akuzuarve, A K për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtës së rreme nga neni 403 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, vepër penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPK-së, RR M ,B B secili veç e veç për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumentit zyrtar neni 434 par 1 të KPK-së, K K dhe G M si bashkëkryes për vepër penale Deklarim i rremë nën betim nga neni 391 par 1 të KPK-së, pas mbajtjes së seancës fillestare në prezencën e Prokurorit të Shtetit –Haxhi Sinanaj dhe të akuzuarve, me dt.**31.01.2019**, mur dhe publikisht shalli këtë :

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit :**

1.A K e bija e M dhe K e gjinisë C, e lindur me .. në fsh. P K.K, tani me banim në Rr. “I K” p.n. në P, ka kryer shkollën e mesme, e pa martuar, e gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës e pa gjykuar më parë, gjendet në liri.

2.RR M i biri i A dhe S e gjinisë F, i lindur me 16.07.1964 në fsh. S K. K ku edhe tani banon, ka kryer shkollën e mesme, me profesion nën punës i gjendjes civile i punësuar në ZGJC në Klinë, i martuar baba i 7 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa gjykuar më parë, gjendet në liri.

3.B B i biri i H dhe V e gjinisë M, i lindur me .. në fsh. D K. K ku edhe tani banon, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion nëpunës- sekretar shkolle, i martuar baba i 5 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa gjykuar më parë, gjendet në liri.

4.K C K e bija e L dhe SH, e gjinisë M, e lindur me ... në fsh. T K. S me banim në Rr. "I K" pn P , ka të kryer shkollën fillore, amvise, e ve, nënë e 6 fëmijëve , e gjendjes se dobët ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës së Kosovës, e pa gjykuar më parë, gjendet në liri.

5. G M i biri i R dhe S e gjinisë M, i lindur me ... në fsh. G K. Klinë ku edhe tani banon , ka të kryer shkollën e fillore , me profesion punëtor fizikë, i martuar baba i 2 fëmijëve , i gjendjes se dobët ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i pa gjykuar më parë, gjendet në liri.

## I

### JANË FAJTORË

#### 1.E Akuzuara A K:

##### Për shkak se :

me dt.12.06.2014, në Klinë , pikërisht në zyrën e gjendjes civile ka vu në lajthim zyrtarët e Zyrës së Gjendjes Civile, ashtu që e pandehura A është regjistruar në librin Amzë të të lindurve LAL( librin e rikonstruimit ), duke prezantua dokumentet e falsifikuara dhe atë vërtetimin e shkollës fillore "... " në Sfërkë, vërtetimin e vaksinimit e lëshuar nga ish shtëpia e shëndetit në Klinë me numër 992/00 të dt.26.09.2000, me të cilat dokumente është shlyer emri A dhe është vendosur emri L, në atë mënyre që e pandehura meqenëse nuk e ka ndjere veten si femër duke përdor dokumentacionet e falsifikuara i ka vu në lajthim zyrtarët e gjendjes civile, se kinse A K ka vdek në vitin 10.05.2006, dhe se fëmija tjetër binjak, pra kinse L K është gjallë por është regjistruar më parë se bashku me A Kn, e të cilat të dhëna për Lin i ka përdorur e pandehura A.

-me çka ka kryer veprë penale legalizimi përmbajtës se rreme nga neni 403 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së

#### 2. I Akuzuari Rraham M

##### Për shkak se :

me dt.12.06.2014, në fshatin S pikërisht në zyrën e gjendjes civile si person zyrtar në regjistrin dhe në dokumentin zyrtar ka shënuar të dhënat e rreme, në atë mënyrë që i pandehuri, në cilësinë e zyrtarit të gjendjes civile duke i përdor dokumentet e falsifikuara të cilat i ia prezantua e pandehura A, këtë të fundit i pandehuri e ka regjistrua në librin Amzë të të lindurve duke ja lëshuar edhe Ekstraktin e lindjes nr. 01366160, por jo ne emër te As por ne emër te L K

-me çka ka kryer veprë penale falsifikimi i dokumenti zyrtar ka neni 434 par.1 të KPK-së

#### 3. I akuzuari B B:

##### Për shkak se :

me dt.06.09.2014, ne shkollën fillore " ...."ne fsh. S K.klinë , ne regjistrin dhe ne dokumentin zyrtar ka shënuar te dhënat e rreme, ne atë mënyrë e pandehura A shkon ne zyrën e te pandehurit RR i cili punon si sekretar shkolle dhe pas prezantimit nga ana e te pandehurës, vërtetimin mbi vaksinim te lëshuar nga shtëpia e shëndetit ne Klinë ne emër te A K ku e pandehura A ne vend te emrit A kishte falsifikuar dhe kishte shënua emrin L, i pandehuri, duke u bazuar ne këtë vërtetim e ka regjistruar personin in-ekzistent këtu L K kinse i lindur me dt. 01.10.1990, nga babai M dhe nena K, nen numër rendor 361 duke ia lëshuar edhe vërtetimin se kinse L K ka qene nxënës i kësaj shkolle ne vitin shkollor 1997/1998, edhe pse e ka ditë që L K nuk ka qenë nxënës i kësaj shkolle fillore.

-me çka ka kryer vepër penale falsifikimi i dokumenti zyrtar ka neni 434 par.1 të KPK-së

#### **4. Të Akuzuarit K K dhe G M :**

Për shkak se:

me dt.14.10.2016 ne Gjykatën Themelore – Pejë Dega ne Klinë , ne cilësinë e dëshmitareve , të pandehurit K dhe G, kanë dhënë deklaratë te rreme nen Betim edhe pse e kanë ditë qe është deklaratë e rreme , por me qellim e fshehjes se fakteve lidhur me te pandehurën A K , ne atë mënyrë qe te pandehurit pranë Gjyqtarit I B kanë deklarua se e ndjera A K nga fsh. P K-Klinë, ka lindur me dt. 01.10.1990, ne fsh. P K-Klinë dhe ka vdekë me dt. 10.05.2006, nga vdekja natyrore ne fsh. P K-Klinë, ku edhe është varrosur, e qe këtë vërtetim me pas e pandehura A e ka përdor për nxjerrje te letërnjoftimit ne emër te L Kt.

-me çka si bashkëkryes kanë kryer vepër penale deklarimi i rrem nën betim nga neni 391 par.1 të KPK-së.

Andaj Gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 21 par.2, 41,42, 43, 45,49,51par.2,73, 74,75, nenit 403 par.2 lidhur me par1, nenin 434 par.1 dhe nenin 391 par.1 të KPK-së lidhur me nenin 248, par.1 dhe 4, nenit 365, 366, 453, të KPPK-së, te akuzuarit i:

### **G J Y K O N**

#### **1.Të akuzuarën A K:**

- me dënim burgimi në kohe zgjatje prej tetë ( 8) muaj.

Dënimi me burg fare nuk ka për tu ekzekutuar me kusht që e akuzuara në afate prej një viti nuk do të kryej vepër të re penale.

E akuzuara detyrohet që Gjykatës në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 25 euro.

#### **2.Të akuzuarin RR M:**

- me dënim burgimi në kohe zgjatje prej gjashtë (6) muaj

Dënimi me burg fare nuk ka për tu ekzekutuar me kusht që i akuzuari në afate prej një viti nuk do të kryej vepër të re penale.

I akuzuari detyrohet që gjykatës në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 25 euro.

#### **3.Të akuzuarin B B:**

-me dënim burgimi në kohe zgjatje prej gjashtë (6) muaj

Dënimi me burg fare nuk ka për tu ekzekutuar me kusht që i akuzuari në afate prej një viti nuk do të kryej vepër të re penale.

I akuzuari detyrohet që gjykatës në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 25 euro.

#### **4.Të akuzuarën K K :**

- me dënim burgimi në kohe zgjatje prej tre ( 3) muaj

Dënimi me burg fare nuk ka për tu ekzekutuar me kusht që e akuzuara në afate prej një viti nuk do të kryej vepër të re penale.

E akuzuara detyrohet që gjykatës në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 25 euro.

#### **5.Të akuzuarin G M :**

- me dënim burgimi në kohe zgjatje prej tre (3) muaj

Dënimi me burg fare nuk ka për tu ekzekutuar me kusht që e akuzuara në afate prej një viti nuk do të kryej vepër të re penale.

I akuzuari detyrohet që gjykatës në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 25 euro.

## **II**

### **Kundër të akuzuarës A K**

Në kuptim te nenit 363 par1. pika 1.1 të KPPK-së

### **REFUZOHET AKTAKUZA**

#### **E akuzuar se:**

Me dt.26.05.2014, në Klinikë duke ndryshuar dokumentin origjinal e me qellim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ka përpiluar dokument të falsifikuar dhe atë vërtetimin e lëshuar nga shtëpia e shëndetit në Klinikë, me numër 994/00 të dt.26.05.2014, në atë mënyre që e pandehura pasi që ka siguruar vërtetimin e cekur si më lartë për në emër të A M K e cila emrin A e ka shlyer dhe mbi të e pandehura e ka shkruar L M K e të cilin vërtetim e ka prezantuar në zyrën e gjendjes civile në Klinikë për tu regjistruar në librin amzë të të lindurve

-me çka ka kryer vepër penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPK-së.

**-për shkak se prokurori i Shtetit në fillim të shqyrtimit gjyqësor ka heq dorë nga aktakuza, për shkak te parashkrimit relativ te ndjekjes penale.**

Të gjitha këto në afate prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore– Departamenti për Krime te Renda ne Pejë me aktakuzën , PP/I. nr. 125/2018 te dt. 19.12.2018, i ka akuzuar , A K për shkak të veprës penale legalizimi i përmbajtës se rreme nga neni 403 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe për vepër penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPK-së, të akuzuarit RR M ,B B secilin veç e veç për shkak te veprës penale Falsifikimi i dokumentit zyrtar neni 434 par 1 te KPK-së, të pandehurit K K dhe G M si bashkëkryes për vepër penale Deklarim i rremë nen betim nga neni 391 par 1 te KPK-së.

Prokurorja e shtetit Valbona Disha-Haxhosaj në fillim të shqyrtimit fillestar tha se në raport me të akuzuarën A K për veprën penale në pikën II të aktakuzës, për vepër penale falsifikimi i dokumenteve nga neni 398 par.1 të KPK-së, heq dore nga aktakuza për shkak se ka arritur parashkrimin relativ të ndjekjes penale.

Ne shqyrtim fillestar Prokurori i shtetit Valbona Disha - Haxhosaj në raport me të gjithë të akuzuarit ka mbete ne tërësi pranë aktakuzës , kualifikimit te njëjtë juridik te veprave penale.

Të akuzuarit secili veç e veç qe ne fillim te shqyrtimit fillestarë në tersi e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohen.

Prokurori i shtetit Valbona Disha- Haxhosaj është pajtuar ne pranimin e fajësisë nga ana e te akuzuarve.

Meqenëse te akuzuarit secili veç e veç janë deklaruar fajtorë për veprat penale për te cilat akuzohen, Prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë, gjykata është e bindur se te akuzuarit i e kanë kuptua natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ata e kanë pranua fajësinë vullnetarisht e pas këshillimeve të mjaftueshme nga ana e gjykatës, pranimi i fajësisë është i bazuar në provat e shkresave të lendes,vërtetimi i lëshuar nga shtëpia e shëndetit në Klinikë nr.994/00 dt.26.05.2014 në emër të L Kt, parapritnim i lëshuar nga ZGJC-S në emër të L Kt, vërtetimi i shkollës fillore “ ...” S nr.169/04 dt. 09.06.2014, procesverbal mbi pranimin e atësisë nga babai dhe nëna e L Kt dt.12.06.2014, deklaratë e dëshmitarit mbi lindjen në shtëpi të L Kt dt. 12.06.2014, vërtetimin nr992/00 dt.25.05.2000, lëshuar nga shtëpia e shëndetit në Klinikë në emër të A Kt origjinali, deklarata e prindërve mbi lindjen në shtëpi të A Kt dt.09.10.2000, dëshmi e personave që janë në dijeni për vdekjen e A Kt të dt.24.10.2016, vërtetimi mjekësor për vdekje nr.000012 të dt.24.10.2016 në emër të A K, parapritim i aktit të vdekjes se A Kt pa datë të shënuar, leshura nga RR M ZGJC- S. Aktakuza nuk përmban asnjë nga shkeljet e qarta ligjore.

Për këtë gjykata gjen se janë plotësuar kërkesat e parapara me nenin 248 par.4 pika 1.1 të KPPK-së ashtu që në kuptim të nenit 248 par. 4 të KPPK-së, e ka pranuar pranimin fajësisë nga ana e të akuzuarve: nga se fajësia argumentohet në prova që vërtetojnë se e akuzuara A K , ditën , kohen, vendin , dhe mënyrën e përshkruar ne pikën I nënpika 1 të dispozitivit te këtij aktgjykimi ka krye vepër penale legalizimi i përmbajtës se rreme nga neni 403 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuari RR M ditën , kohen, vendin , dhe mënyrën e përshkruar ne pikën I nënpika 2 të dispozitivit te këtij aktgjykimi ka krye vepër penale falsifikimi i dokumentit zyrtar neni 434 par 1 te KPK-së, i akuzuari B B ditën , kohen, vendin , dhe mënyrën e përshkruar ne pikën I nënpika 3 të dispozitivit te këtij aktgjykimi ka krye vepër penale falsifikimi i dokumentit zyrtar neni 434 par 1 te KPK-së, të akuzuarit K K dhe G M ditën , kohen, vendin , dhe mënyrën e përshkruar ne pikën I nënpika 4 të dispozitivit te këtij aktgjykimi ka krye vepër penale si bashkëkryes deklarim i rremë nen betim nga neni 391 par 1 te KPK-së.

Për këtë gjykata te akuzuarit secilin veç e veç i ka shpallur fajtor dhe penalisht përgjegjës.

Para se te vendosë mbi llojin dhe lartësinë e dënimit , Gjykata i ka vlerësua propozimet e palëve ne procedurë dhe nga te dhënat tjera , rrethanë renduese për asnjërin prej të akuzuarve nuk ka gjetë . Ndërsa si rrethana lehtësuese për te akuzuarit ,për secilin veç e veç, janë marr sjellja e te akuzuarve para dhe pas kryerjes se veprës penale , faktin se ata nuk kanë qen të gjykura më par për ndonjë vepër penale dhe ata nuk kanë kryer vepër tjetër penale, janë prindër, mbajtës të familjes ,gjendja tejet e dobët ekonomike posaçërisht faktin se arta qe ne fillim e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohen.

Duke pasur parasysh edhe këto rrethana, gjykata duke aplikua dispozitat për zbutjen e dënimit , kufijve të lejuar e paraparë me nenin 75 par 1 pika 1.2 e lidhur me nenin 76 par. 1 pika 1.5 e KPK-së të akuzuarit i ka gjykuar me dënim burgimi të akuzuarën A K me dënim burgimi në kohëzgjatje prej tete muaj, RR M dhe B B me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga gjashtë muaj, dhe të akuzuarit K K dhe G M me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga tre muaj dhe është vendos që dënimet fare nuk kanë për tu ekzekutua, me kusht qe të akuzuarit për secilin veç e veç , të mos kryejnë vepër tjetër të re penale .

.Duke i vlerësua kështu të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato renduese , gjykata ka ardh ne përfundim se dënimet e shqiptuar janë ne proporcion me shkallen e përgjegjësisë penale të akuzuarve, rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale të kryera dhe me intensitetin e pasojës së shkakuar, e duke qen të sigurt se dënimet e shqiptuar janë i baras-peshuar dhe do të jetnë ne funksion të arritjes së qëllimit të dënimit , si preventiv për pengimin e të akuzuarve , por edhe të personave tjerë, nga kryerja e veprave penale dhe se fundi, një dënim i tillë do t e ndikoj ne risocializimin dhe riedukimin e të akuzuarve .

Vendimi qe të akuzuarit secili veç e veç te ja kompensoj gjykatës shpenzimet e procedurës penale ne forme paushallë është i bazuar ne nenin 450 par.1 dhe 2 pikat 2.1,2.2 dhe 2. 6 të KPPK-së dhe është gjykua në lartësinë si në dispozitiv, me bindje se të akuzuarit i kanë kushtet për përmbarrim.

Nga sa u tha me lartë , u vendosë si ne pikën I të dispozitivit te këtij aktgjykimi.

Me që Prokurorja e shtetit, në fillim të shqyrtimit gjyqësor ka heqë dore nga aktakuza në raport me të akuzuarën A K për veprën penale në pikën II të aktakuzës për shkak se vepra ka arritur parashkrimin relativ të ndjekjes penale, Gjykata në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.1 të KPPK-së , ka vendosë si ne pikën II të dispozitivit te këtij aktgjykimi.

**U VENDOS NE GJYKTEN THEMELORE – Departamenti për krime të Rënda ne Pejë,  
me dt.31.01.2019.  
DKR. P.nr 111/2018**

Sekretarja Juridike  
Binake Mulliqi

Kryetari i Trupit Gjyqësor- Gjyqtari  
Sylë Lokaj

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa me afat prej 15 ditësh pas marrjes ,gjykatës se apelit në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate